



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 11

18 shkurt

2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 1/2013 datë 31.1.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për transferimin e personave të dënuar.....	315
Ligj nr. 2/2013 datë 31.1.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ekstradimin.....	320
Ligj nr. 3/2013 datë 31.1.2013	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale.....	328
Ligj nr. 4/2013 datë 31.1.2013	Për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqes në ngastrat e ekonomive pyjore, që pritet të përmyten nga liqeni i HEC-eve të Banjës, Koklit dhe Moglicës, të cilët do të ndërtohen në kaskadën e lumit Devoll.....	337

LIGJ
Nr. 1/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për transferimin e personave të dënuar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 31.1.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7943, datë 13.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE
TË DËNUAR

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të referuara si “Palët”,

duke dëshiruar zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale;

duke konsideruar se një bashkëpunim i tillë duhet të çojë më tej qëllimet e drejtësisë dhe rehabilitimin social të personave të dënuar;

duke parë se këta objektiva kërkojnë që personave, të cilëve u është hequr liria si rezultat e kryerjes së një vepre penale, duhet t’u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre;

duke vlerësuar se ky qëllim mund të arrihet më mirë, duke i transferuar ata në vendet e tyre, kanë rënë dakord me sa vijon:



Neni 1 **Përkufizime**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

“Dënim” do të thotë çdo dënim përfundimtar apo masë që ka të bëjë me heqjen e lirisë, të vendosur nga një gjykatë si rezultat i një veprë penale.

“Vendim” është çdo vendim ose urdhër i gjykatës me të cilin është dhënë dënimi.

“Shteti dënues” është shteti në të cilin është dhënë dënimi për personin, i cili mund të transferohet ose është transferuar.

“Shteti zbatues” është shteti në të cilin personi i dënuar mund ose është transferuar për të vuajtur dënimin.

“Autoritetet qendrore” janë ministritë e drejtësisë të palëve respektive.

Neni 2 **Parime të përgjithshme**

1. Palët marrin përsipër t’i ofrojnë njëra-tjetrës masën më të gjerë të bashkëpunimit në lidhje me transferimin e personave të dënuar në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

2. Personi i dënuar në territorin e shtetit dënues mund të transferohet në territorin e shtetit zbatues, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, për të vuajtur dënimin e dhënë. Për këtë qëllim ai mund të shprehë interesin e tij te shteti dënues ose te shteti zbatues për transferimin e tij në përputhje me këtë Marrëveshje.

3. Transferimi mund të kërkohet nga shteti dënues ose nga shteti zbatues.

Neni 3 **Kushtet për transferim**

1. Personi i dënuar mund të transferohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) personi është shtetas i shtetit zbatues;

ii) vendimi është i formës së prerë;

iii) në kohën e pranimit të kërkesës për transferim, personi i dënuar ka ende të paktën gjashtë muaj burgim nga dënimi për të vuajtur;

iv) personi i dënuar jep pëlqimin për transferimin ose, duke marrë parasysh moshën ose gjendjen e tij fizike apo mendore dhe, kur njëri prej palëve e konsideron atë si të nevojshme, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të personit të dënuar;

v) veprimet apo mosveprimet, në bazë të të cilave është dhënë dënimi, përbëjnë vepër penale sipas legjislacionit të shtetit zbatues ose do të përbënte vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij; dhe

vi) shteti dënues dhe shteti zbatues janë dakord me transferimin.

2. Në raste të veçanta, palët mund të bien dakord me një transferim edhe nëse koha që duhet të vuajë personi i dënuar është më e shkurtër se ajo e përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi “iii” të këtij neni.

3. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për aq sa është e mundur edhe për personat e papërgjegjshëm penalisht që kanë kryer vepër penale, për të cilët gjykata ka vendosur heqjen e lirisë nëpërmjet shtrimit të detyruar në një institucion psikiatrik.

Neni 4

Detyrimi për të dhënë informacion

1. Çdo person i dënuar për të cilin zbatohet kjo Marrëveshje informohet nga shteti dënues mbi përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interes shtetit dënues për t'u transferuar në përputhje me këtë Marrëveshje, ai shtet njofton shtetin zbatues pa vonesë, sapo vendimi të ketë marrë formë të prerë.

3. Informacioni përfshin:

- i) emrin, datën dhe vendin e lindjes së personit të dënuar;
- ii) adresën e tij, nëse ka, në shtetin zbatues;
- iii) përshkrimin e fakteve mbi të cilat është bazuar dënimi; dhe
- iv) natyrën, kohëzgjatjen dhe datën e fillimit të dënimit.

4. Nëse personi i dënuar i ka shprehur interesin e vet shtetit zbatues, shteti dënues me kërkesë i komunikon atij shteti informacionin e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni.

5. Personi i dënuar informohet me shkrim dhe në gjuhën të cilën ai e kupton për çdo veprim të ndërmarrë nga palët në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni, si edhe për çdo vendim të palëve lidhur me kërkesën për transferimin e tij.

Neni 5

Komunikimi

1. Kërkesat dhe përgjigjet për transferim bëhen me shkrim.

2. Komunikimi ndërmjet palëve bëhet drejtpërdrejt midis autoriteteve qendrore, megjithatë komunikimi përmes kanaleve diplomatike nuk përjashtohet.

3. Palët informojnë njëra-tjetrën në kohën e duhur për vendimet e pranimit ose jo për transferimin e kërkuar.

Neni 6

Dokumentet shoqëruese

1. Shteti zbatues i paraqet shtetit dënues, nëse kërkohet prej tij:

- i) dokument apo deklaratë që tregon se personi i dënuar është shtetas i atij shteti;
- ii) kopje të dispozitave ligjore përkatëse të shtetit zbatues, që tregojnë që kryerja apo moskryerja e veprimit për të cilin është dhënë dënimi në shtetin dënues përbën vepër penale, sipas legjislacionit në shtetin zbatues apo përbën vepër penale nëse do të ishte kryer në territorin e tij

2. Kur kërkohet transferimi, shteti dënues i paraqet dokumentet e mëposhtme shtetit zbatues:

- i) një kopje të njësuar të vendimit dhe të ligjit mbi të cilin është bazuar vendimi;
- ii) një deklaratë ku tregohet se sa kohë e dënimit është vuajtur, duke përfshirë të dhënat për paraburgimin, shkurtimet e dënimeve, si dhe për çdo fakt tjetër të rëndësishëm që ka të bëjë me ekzekutimin e dënimit;

iii) deklaratë që përmban pëlqimin për transferim sipas nenit 3, paragrafit 1, nënparagrafi “iv” të kësaj Marrëveshjeje.

iv) kur është e nevojshme, raport mjekësor apo shoqëror për personin e dënuar, të dhëna lidhur me trajtimin e tij dhe çdo rekomandim tjetër lidhur me trajtimin e tij në shtetin zbatues.

3. Këto dokumente nuk paraqiten nëse një prej palëve ka njoftuar se nuk është dakord me transferimin.

4. Palët, përpara se t'i paraqesin njëra-tjetrës kërkesën për transferimin ose përpara marrjes së vendimit për transferimin, kërkojnë të pajisen me dokumentet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.



Neni 7 **Pëlqimi dhe verifikimi**

1. Shteti dënues siguron që personi i dënuar ka dhënë pëlqimin për transferim në përputhje me nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi “iii” dhe e ka bërë këtë me vullnetin e tij dhe në dije të plotë për pasojat, duke përfshirë kushtet e burgimit, shërbimet që ofrohen, të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve në shtetin zbatues. Procedura për dhënien e pëlqimit zbatohet sipas legjislacionit të shtetit dënues.

2. Shteti dënues i jep mundësi shtetit zbatues që të verifikojë nëpërmjet një konsulli ose një zyrtari tjetër, për të cilin është rënë dakord me shtetin zbatues, që pëlqimi është dhënë në përputhje me kushtet e përcaktuara të këtij neni.

Neni 8 **Efektet e transferimit në shtetin dënues**

1. Marrja përsipër e ekzekutimit të dënimit ndaj personit të transferuar nga autoritetet e shtetit zbatues do të kenë efekt të suspendimit të dënimit në shtetin dënues.

2. Shteti dënues nuk mund të ekzekutojë më tej dënimin, nëse shteti zbatues e konsideron ekzekutimin e dënimit si të përfunduar.

Neni 9 **Efektet e transferimit për shtetin zbatues**

Autoritetet kompetente të shtetit zbatues duhet:

i) të vazhdojnë ekzekutimin e dënimit menjëherë ose nëpërmjet një vendimi dënimi sipas kushteve të përcaktuara në nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje;

ii) të shndërrojë dënimin me anë të një procedure gjyqësore ose administrative në një vendim të atij shteti, duke zëvendësuar kështu sanksionin e dhënë nga shteti dënues me një sanksion të parashikuar nga ligji i shtetit zbatues për të njëjtën veprë penale, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në rast kërkesë shteti zbatues informon shtetin dënues para transferimit të personit të dënuar, për sa i përket procedurës që do të ndiqet.

3. Ekzekutimi i dënimit rregullohet nga ligji i shtetit zbatues dhe vetëm shteti zbatues është kompetent për të marrë të gjitha vendimet përkatëse.

Neni 10 **Ekzekutimi i vazhduar**

1. Në rastin e vazhdimit të ekzekutimit, shteti zbatues është i detyruar t’i përmbahet natyrës juridike dhe kohëzgjatjes së dënimit, siç është përcaktuar në shtetin dënues.

2. Nëse ky dënim nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin e shtetit zbatues ose kur kjo parashikohet nga ligji i tij, ai shtet, me anë të një urdhri gjyqësor ose administrativ, mund të adoptojë sanksionin me dënimin ose masën e parashikuar nga ligji i vet për veprën penale. Për sa i përket natyrës së tij, dënimi ose masa, nëse është e mundur, duhet të korrespondojë me atë të dhënë nga dënimi për t’u ekzekutuar. Për nga natyra ose kohëzgjatja, ai nuk duhet të rëndojë sanksionin e dhënë nga shteti dënues dhe nuk duhet të kalojë maksimumin e parashikuar nga shteti zbatues.

Neni 11
Konvertimi i dënimit

1. Në rastin e konvertimit të dënimit, zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:

- i) duhet t'u përmbahet konstatimeve në lidhje me faktet e përcaktuara shprehimisht ose që nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;
- ii) nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;
- iii) shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë së vuajtur nga personi i dënuar;
- iv) nuk e rëndon pozitën penale të personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t'i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera.

2. Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti zbatues e mban atë person të ndaluar ose siguron në ndonjë mënyrë tjetër praninë e tij në shtetin zbatues, derisa të dalë rezultati i procedurës.

Neni 12
Falja dhe amnistia

1. Secili shtet mund të japë falje ose amnisti në përputhje me legjislacionin e tij të brendshëm dhe njofton për këtë shtetin tjetër.

2. Në rast se dënimi falet ose amnistohet nga shteti dënues dhe shteti dënues i dërgon aktet te shteti zbatues, autoriteti qendror i shtetit zbatues procedon sipas legjislacionit të tij të brendshëm.

Neni 13
Rishikimi i vendimit

Vetëm shteti dënues ka të drejtën për të vendosur mbi çdo kërkesë për rishikimin e vendimit.

Neni 14
Përfundimi i ekzekutimit

Shteti zbatues përfundon ekzekutimin e dënimit menjëherë sapo të informohet nga shteti dënues për çdo vendim ose masë, si rezultat i të cilit dënimi duhet të përfundojë.

Neni 15
Informacioni për ekzekutimin

Shteti zbatues i jep informacion shtetit dënues në lidhje me ekzekutimin e dënimit:

- i) kur ai e konsideron ekzekutimin e dënimit të përfunduar;
- ii) nëse personi i dënuar është arratisur nga institucioni i vuajtjes së dënimit para përfundimit të ekzekutimit të dënimit; ose
- iii) kur shteti dënues kërkon një raport të veçantë.

Neni 16
Gjuha dhe shpenzimet

1. Në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, informacionet përcillen në gjuhën zyrtare të palës së kërkuar:

- i) për Republikën e Shqipërisë, në gjuhën shqipe;
- ii) për Republikën e Kosovës, në gjuhën shqipe ose serbe.



2. Përveç kufizimit të parashikuar në nenin 6 paragrafi 2 nënparagrafi “i”, dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Marrëveshjeje nuk nevojiten të njësuara.

3. Shpenzimet e kryera nga zbatimi i kësaj Marrëveshjeje përballohen nga shteti zbatues, përveç shpenzimeve të kryera ekskluzivisht në territorin e shtetit dënues dhe shpenzimet lidhur me transportin e personit të dënuar deri në kufi të shtetit zbatues ose, në rast të transportimit ajror, deri në aeroportin e destinacionit përfundimtar, përveç nëse palët vendosin ndryshe.

Neni 17

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit në përputhje me procedurat ligjore të palëve dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas njoftimit të fundit, përmes kanaleve diplomatike të palëve se procedurat e brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përfunduar.

2. Kjo Marrëveshje është e zbatueshme për zbatimin e dënimeve të dhëna para ose pas hyrjes së saj në fuqi.

3. Marrëveshja lidhet për një afat kohor të pacaktuar dhe përfundon 6 muaj pasi njëra nga palët njofton palën tjetër për përfundimin e saj.

4. Secila prej palëve mund të kërkojë denoncimin e Marrëveshjes, në çdo kohë duke i dërguar njoftim me shkrim palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Denoncimi i kësaj Marrëveshjeje hyn në fuqi 6 muaj pas marrjes së këtij njoftimi. Kjo Marrëveshje vazhdon të jetë e zbatueshme për ekzekutimin e dënimeve të personave, të cilët janë transferuar në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes para datës në të cilën ka hyrë në fuqi denoncimi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 6.11.2012, në gjuhët shqipe dhe serbe, të gjitha tekstet njësoj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën shqipe do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE
MINISTRI I DREJTËSISË
Hajredin Kuçi

LIGJ

Nr. 2/2013

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR EKSTRADIMIN

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ekstradimin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 31.1.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7944, datë 13.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI EKSTRADIMIN**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të referuara si “Palët”;

duke marrë në konsideratë dëshirën për pjesëmarrje aktive në procesin e bashkëpunimit me shtetet europiane;

duke dëshiruar të nxisin bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale në frymën e respektit reciprok për parimin e sovranitetit dhe barazisë së të drejtave;

të vetëdijshëm se krijimi i marrëveshjeve dypalëshe për ekstradimin do të kontribuojë në zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit më efektiv ndërkombëtar për luftën kundër krimit;

duke njohur nevojën për të lehtësuar procedurat e ekstradimit në shkallën më të lartë të mundshme;

duke marrë në konsideratë që legjislacioni i të dyja palëve nuk e njeh dënimin me vdekje, kanë rënë dakord me sa vijon:

KAPITULLI I

PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Detyrimi për ekstradim

1. Palët marrin përsipër të dorëzojnë te njëra-tjetra, sipas dispozitave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, të gjithë personat kundër, të cilëve autoritetet kompetente të palës kërkuese kanë filluar procedurën gjyqësore për veprë penale ose që janë të kërkuar nga autoritetet e saj për ekzekutimin e një dënimi apo urdhërarresti.

2. Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, shprehja “urdhërarrest” nënkupton çdo vendim apo urdhër për privimin e lirisë të dhënë nga autoriteti gjyqësor kompetent, në kuadër të një procedure penale.

Neni 2

Veprat penale të ekstradueshme

1. Ekstradimi lejohet lidhur me veprat penale për të cilat plotësohen kushtet e mëposhtme:

i) vepra penale për të cilën kërkohet ekstradimi është e dënueshme nga legjislacioni i të dyja palëve me burgim jo më pak se 1 vit.

ii) kohëzgjatja ose pjesa e mbetur e dënimit të dhënë me vendim gjyqësor të formës së prerë është të paktën 6 muaj.



Neni 3 **Veprat penale politike**

1. Ekstradimi refuzohet nëse vepra penale për të cilën është paraqitur kërkesa, nga pala e kërkuar konsiderohet si vepër penale politike ose vepër që është e ndërlidhur me një vepër penale politike.

2. E njëjta rregull zbatohet nëse pala e kërkuar ka arsye të bazuara për të besuar se kërkesa e parashtruar për ekstradim për një vepër penale të zakonshme është bërë me qëllim të ndjekjes ose dënimit të një personi për shkak të racës, besimit fetar, kombësisë ose bindjeve politike, ose pozita e personit mund të cenohet për ndonjërin nga këto arsye.

3. Vrasja apo tentativa e vrasjes së kryetarit të shtetit, kryetarit të qeverisë ose Ministrit të Punëve të Jashtme, kur këta ndodhen në njërin nga palët dhe anëtarët e familjes që i shoqërojnë, si dhe çdo përfaqësues ose zyrtar i një prej palëve, ose çdo zyrtar apo agent i një organizate ndërkombëtare me karakter ndërqeveritar, i cili, në kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale kundër tij, zyrës, banesës private ose mjeteve të tij të transportit, gëzon, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtje të posaçme nga çdo sulm mbi personin, lirinë dhe dinjitetin e tij, si dhe anëtarët e familjes së tij, nuk konsiderohet vepër politike për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.

4. Ky nen nuk cenon asnjë detyrim që palët mund të kenë marrë ose mund të marrin sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërkombëtare shumëpalëshe.

Neni 4 **Veprat penale ushtarake**

Kjo Marrëveshje nuk zbatohet për ekstradimin për veprat penale ushtarake, të cilat konsiderohen vepra penale sipas ligjit ushtarak, por nuk parashikohen si vepra penale sipas ligjit penal të zakonshëm.

Neni 5 **Veprat penale fiskale**

Ekstradimi për veprat penale që kanë të bëjnë me taksat, tatimet dhe detyrimet doganore apo për vepra të tjera penale fiskale, lejohet ndërmjet palëve në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, nëse vepra penale parashikohet nga legjislacioni i të dyja palëve, pavarësisht emërimit të saj ligjor.

Neni 6 **Ekstradimet e shtetasve**

1. Palët marrin përsipër, në mënyrë të ndërsjellë, të dorëzojnë shtetasit e tyre që ndodhen në ndjekje penale nga njëra prej tyre për kryerjen e veprave penale ose që janë shpallur në kërkim për vuajtjen e dënimit apo të një mase shtrënguese, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

2. Palët nuk mund të ngrenë shtetësinë si arsye për refuzimin e dorëzimit.

3. Kërkesat për ekstradimin bëhen drejtpërdrejt midis autoriteteve të tyre qendrore.

Neni 7 **Vendi i kryerjes së veprës penale**

1. Pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin e personit që kërkohet për veprën penale, e cila sipas ligjit të saj, konsiderohet se është kryer pjesërisht apo tërësisht brenda territorit të saj.

2. Në rast se vepra penale për të cilën është kërkuar ekstradimi është kryer jashtë territorit të palës kërkuese, ekstradimi mund të refuzohet vetëm nëse ligji i palës së kërkuar nuk e lejon ndjekjen e veprave penale të asaj kategorie, të cilat janë kryer jashtë territorit të saj, apo nuk e lejon ekstradimin për vepra të tilla.

Neni 8

Zhvillimi i procedurës për të njëjtën vepër penale

Pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin e personit të kërkuar, nëse autoritetet kompetente të saj janë duke zhvilluar procedurë penale kundër tij/saj në lidhje me veprën penale ose veprat penale për të cilat është kërkuar ekstradimi.

Neni 9

Ne bis in idem

Ekstradimi nuk lejohet nëse është dhënë një vendim i formës së prerë nga autoritetet gjyqësore kompetente të palës së kërkuar ndaj personit të kërkuar për veprën ose veprat penale, për të cilat kërkohet ekstradimi. Ekstradimi mund të refuzohet nëse autoritetet gjyqësore kompetente të palës së kërkuar kanë vendosur të mos fillojnë ose të përfundojnë procedurën penale për të njëjtën vepër ose vepra penale.

Neni 10

Parashkrimi

Ekstradimi nuk lejohet nëse sipas ligjit të të dyja palëve, ndjekja penale ose ekzekutimi i dënimit është parashkruar.

Neni 11

Gjykimet në mungesë

1. Kur njëra nga palët kërkon ekstradimin e një personi me qëllim të ekzekutimit të një dënimi ose urdhërarresti të dhënë ndaj tij në mungesë, pala e kërkuar mund të refuzojë ekstradimin, nëse sipas vlerësimit të saj, procedura gjyqësore nuk i ka përmbushur të drejtat minimale të mbrojtjes. Megjithatë, ekstradimi lejohet, në qoftë se pala kërkuese jep garanci se i ekstraduari, nëse është gjykuar në mungesë, ka të drejtën e rigjyimit ose të rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij.

2. Kur pala e kërkuar i njofton personit të kërkuar për t'u ekstraduar, vendimin e dhënë në mungesë, pala kërkuese nuk e konsideron këtë komunikim si një njoftim formal zyrtar për qëllimet e procedurës penale në atë shtet.

Neni 12

Amnistia ose falja

Ekstradimi nuk lejohet për një vepër penale për të cilën një amnisti ose falje është shpallur në shtetin, të cilit i paraqitet kërkesa.



KAPITULLI II PROCEDURA E DORËZIMIT

Neni 13

Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese

1. Palët i paraqesin me shkrim kërkesat për ekstradim dhe dokumentet e tjera shoqëruese në rastin e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës në gjuhën shqipe ose serbe dhe në rastin e Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë në gjuhën shqipe. Megjithatë, komunikimi përmes kanaleve diplomatike mes palëve nuk përjashtohet.

2. Kërkesa shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

- i) origjinali ose kopja e njëzuar e vendimit të dënimit ose të urdhërarrestit;
- ii) përshkrimin e veprës penale për të cilën është kërkuar ekstradimi, koha dhe vendi i kryerjes së saj, cilësimi ligjor i veprës penale;
- iii) teksti i dispozitave ligjore të zbatueshme; dhe
- iv) të dhënat individuale dhe çdo informacion tjetër të mundshëm, që shërben për të përcaktuar identitetin dhe shtetësinë e personit, për të cilin kërkohet ekstradimi.

Neni 14

Informacion shtesë

Në rast se informacioni i dërguar në mbështetje të kërkesës së ekstradimit, nuk është i mjaftueshëm që t'i mundësojë palës së kërkuar, për të marrë një vendim në bazë të kësaj Marrëveshjeje, pala e kërkuar mund të kërkojë informacionin e nevojshëm shtesë dhe mund të caktojë një afat kohor për pranimin e tij.

Neni 15

Arrestimi i përkohshëm

1. Në raste urgjente, pala kërkuese mund të kërkojë arrestimin e përkohshëm të personit të kërkuar. Pala e kërkuar vendos lidhur me këtë çështje, në përputhje me legjislacionin e saj.

2. Kërkesa për arrestimin e përkohshëm duhet të tregojë qëllimin për dërgimin e kërkesës për ekstradim dhe se ekziston një nga dokumentet e përcaktuara në nenin 13, paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje. Gjithashtu, ajo duhet të tregojë veprën penale për të cilën do të kërkohet ekstradimi, kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, si dhe një përshkrim të personit të kërkuar, nëse është e mundur.

3. Kërkesa për arrestim të përkohshëm paraqitet me shkrim, me faks ose me ndonjë mjet tjetër të komunikimit, që konfirmon marrjen. Pala e kërkuar duhet të njoftohet pa vonesë lidhur me rezultatin e kërkesës së saj.

4. Arresti i përkohshëm mund të ndërpritet dhe personi lirohet, në qoftë se brenda një periudhe prej 18 ditësh pas arrestimit, pala e kërkuar nuk ka pranuar kërkesën për ekstradim dhe dokumentet e përcaktuara në nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje. Në asnjë rast, arresti i përkohshëm nuk duhet të tejkalojë periudhën prej 40 ditësh nga data e arrestimit. Mundësia e lirimit me kusht, në çdo kohë, nuk është e përjashtuar, megjithatë, pala e kërkuar merr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ikjen e personit të kërkuar.

5. Lirimi nuk përjashton mundësinë e riarrestimit, nëse kërkesa për ekstradim është pranuar më vonë.

Neni 16

Kërkesat konkurruese

Nëse ekstradimi kërkohet njëkohësisht nga njëra palë dhe nga një ose më shumë shtete të tjera, për vepra të njëjta penale ose të ndryshme, pala e kërkuar merr vendim duke pasur parasysh të gjitha rrethanat dhe sidomos rëndësinë e veprës, vendin e kryerjes së veprës penale, datat përkatëse të kërkesave, shtetësinë e personit të kërkuar dhe mundësinë e ekstradimit të mëvonshëm në njërin prej shteteve kërkuese.

Neni 17

Dorëzimi i personit që ekstradohet

1. Pala e kërkuar informon palën kërkuese me anë të mjeteve të përmendura në nenin 13, paragrafi 1 lidhur me vendimin e saj për ekstradimin.
2. Vendimi që refuzon plotësisht apo pjesërisht ekstradimin, në çdo rast duhet të arsyetohet.
3. Nëse ekstradimi lejohet, pala e kërkuar informon palën kërkuese për vendin, datën e dorëzimit dhe kohëzgjatjen e arrestit të personit me qëllim të ekstradimit.
4. Nëse rrethanat përtej kontrollit të saj nuk mundësojnë palën që ta dorëzojë ose ta marrë personin që ekstradohet, ajo do të njoftojë palën tjetër. Të dyja palët do të caktojnë një datë të re për dorëzim dhe do të zbatohen dispozitat e paragrafit 5 të këtij neni.
5. Sipas dispozitave të paragrafit 4 të këtij neni, nëse personi i kërkuar nuk është marrë në datën e caktuar, ai mund të lirohet pas kalimit të 30 ditëve. Pala parashtruese e kërkesës mund të refuzojë ekstradimin e tij për të njëjtën vepër penale.

Neni 18

Dorëzimi i shtyrë apo i kushtëzuar

1. Pala e kërkuar pas marrjes së vendimit për ekstradim, mund të vendosë që të shtyjë dorëzimin e personit të kërkuar me qëllim që të zhvillojë procedurë penale kundër tij në atë shtet apo, në rast se ky person është dënuar, pala e kërkuar mund të shtyjë dorëzimin e tij me qëllim që të ekzekutojë dënimin në territorin e tij për një vepër penale tjetër nga ajo për të cilën është kërkuar ekstradimi.
2. Pala e kërkuar mund të vendosë që në vend të shtyrjes së dorëzimit, të bëjë dorëzimin e përkohshëm të pala kërkuese të personit të kërkuar, në përputhje me kushtet që do të përcaktohen me marrëveshje reciproke ndërmjet palëve.

Neni 19

Dorëzimi i sendeve

1. Pala e kërkuar duhet që, me kërkesë të palës kërkuese dhe për aq sa e lejon legjislacioni i saj, të bëjë konfiskimin dhe dorëzimin e sendeve:
 - i) që mund të kërkohen si provë; apo
 - ii) që është fituar si rezultat i veprës penale dhe e cila në kohën e arrestimit është gjetur në posedim të personit të kërkuar apo është zbuluar më vonë.
2. Sendet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, dorëzohen edhe në rast se ekstradimi i lejuar nuk mund të ekzekutohet për shkak të vdekjes apo ikjes së personit të kërkuar.
3. Nëse sendet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni i janë nënshtruar sequestrimit apo konfiskimit për qëllime të një procedure gjyqësore në palën e kërkuar, atëherë kjo e fundit mund të vendosë t'i mbaj sendet përkohësisht deri në përfundimin e procedurës gjyqësore ose mund të vendosë t'i dorëzohen palës kërkuese me kusht që ato të rikthehen.



4. Çdo e drejtë që pala kërkuese ose ndonjë person i tretë mund të ketë mbi sendet e lartpërmendura, nuk duhet të cenohet. Në këto raste, pas gjykimit, sendet kthehen te pala e kërkuar pa vonesë.

Neni 20

Procedura e zbatueshme

Përveç rasteve kur kjo Marrëveshje parashikon ndryshe, procedurat lidhur me ekstradimin apo arrestin e përkohshëm rregullohen nga legjislacioni i palës së kërkuar.

KAPITULLI III

EFEKTET E DORËZIMIT

Neni 21

Parimi i specialitetit

1. Personi, i cili është ekstraduar nuk hetohet, dënohet apo arrestohet me qëllim të ekzekutimit të një vendimi apo urdhërarresti për ndonjë veprë tjetër penale, të kryer para dorëzimit të tij përveç asaj për të cilën ai është ekstraduar. Gjithashtu atij nuk do t'i kufizohet liria personale, përveç rasteve të mëposhtme:

i) Pala që e ka dorëzuar jep pëlqimin. Kërkesa për pëlqim paraqitet e shoqëruar me dokumentet e përcaktuara në nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje dhe me një procesverbal që përmban deklaratën e personit të ekstraduar për veprën penale përkatëse. Pëlqimi duhet dhënë në rastet kur vepra penale përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

ii) Personi edhe pse ka pasur mundësinë të largohet nga territori i palës kërkuese nuk e ka bërë këtë brenda 45 ditëve nga data e lirimit të tij përfundimtar apo është kthyer në atë territor, pasi e ka lënë atë.

2. Pala kërkuese mund të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për largimin e këtij personi nga territori i saj apo masa për parandalimin e efekteve juridike të parashkrimit, duke përfshirë edhe procedurat e gjykimit në mungesë.

3. Në rast se cilësimi ligjor i veprës penale në ngarkim të personit të ekstraduar pëson ndryshime gjatë zhvillimit të procedurës, ai mund të gjykohej apo të dënohet vetëm nëse vepra penale në bazë të cilësimit ligjor të ri vlerësohet se përmban elemente të veprës penale për të cilat është lejuar ekstradimi.

Neni 22

Ekstradimi i thjeshtësuar

Palët pajtohen që të njohin ekstradimin e thjeshtësuar sipas rregullave të legjislacionit të tyre të brendshëm.

Neni 23

Riekstradimi në një shtet të tretë

Përveç sa parashikohet në nenin 21, paragrafi 1 nënparagrafi "ii" të kësaj Marrëveshjeje, pala kërkuese nuk e dorëzon personin e ekstraduar pa pëlqimin e palës së kërkuar, te një shtet i tretë, për veprat të kryera para dorëzimit të tij. Për këtë qëllim pala e kërkuar mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve të përmendura në nenin 13, paragrafi 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 24
Transiti

1. Transiti nëpër territorin e njëres prej palëve jepet me paraqitjen e një kërkesë me shkrim, me kusht që vepra penale përkatëse të jetë në fushën e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa për transit duhet të shoqërohet nga dokumentet e përmendura në nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Autorizimi nuk kërkohet kur përdoret transporti ajror dhe nuk ka ulje të planifikuara në territorin e shtetit të transimit. Në rast të një uljeje të paparashikuar, pala kërkuuese do të njoftojë palën e kërkuar dhe ky njoftim ka efektin e një kërkesë për arrest të përkohshëm, dhe pala kërkuuese do të paraqesë një kërkesë formale për transit.

KAPITULLI IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 25
Shpenzimet

1. Pala e kërkuar do të mbulojë të gjitha shpenzimet, sipas juridiksionit të saj, që rrjedhin nga procedurat e ekstradimit.

2. Pala kërkuuese mbulon të gjitha shpenzimet e kryera për kalimin e personit nëpër territorin e palës së kërkuar.

Neni 26
Fusha e zbatimit

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për të gjitha kërkesat për ekstradim për veprat penale të cilat janë të kryera para dhe pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 27
Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshjeje i nënshtrohet ratifikimit në përputhje me procedurat ligjore të palëve dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas njoftimit të fundit, përmes kanaleve diplomatike të palëve se procedurat e brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë përfunduar.

2. Marrëveshja lidhet për një afat kohor të pacaktuar dhe përfundon 6 muaj pasi njëra nga palët njofton palën tjetër për përfundimin e saj.

3. Secila nga palët mund të denoncojë këtë marrëveshjeje nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër. Denoncimi i kësaj Marrëveshjeje hyn në fuqi 6 muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshjeje.

Bërë në Tiranë, më 6.11.2012, në gjuhët, shqipe dhe serbe, të gjitha tekstet njëlloj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën shqipe do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE MINISTRI
I DREJTËSISË
Hajredin Kuçi



LIGJ
Nr. 3/2013

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJET PENALE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 31.1.2013

**Shpallur me dekreten nr.7945, datë 13.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË
ÇËSHTJET PENALE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të referuara si “Palët”,

duke pasur në konsideratë aspiratat e tyre për zhvillimin dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dypalëshe në frymën e miqësisë ekzistuese dhe bashkëpunimin, për sa i përket ndihmës së ndërsjellë juridike në çështjet penale ndërmjet dy shteteve;

duke pasur në konsideratë dëshirën për pjesëmarrje aktive në procesin e bashkëpunimit me shtetet europiane,

kanë rënë dakord me sa vijon:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit të ndihmës së ndërsjellë juridike

1. Palët marrin përsipër t’i ofrojnë njëra-tjetrës, në përputhje me këtë Marrëveshje, ndihmën më të gjerë të ndërsjellë juridike në çështjet penale në lidhje me veprat dhe dënimet, të cilat në

kohën e paraqitjes së kërkesës për ndihmë janë në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese.

2. Ndihma e ndërsjellë juridike përfshin:

- i) marrjen e dëshmive apo deklaratave të personave;
- ii) sigurimin e dokumenteve, të dhënave dhe provave;
- iii) njoftimin e dokumenteve dhe të akteve procedurale;
- iv) gjetjen apo identifikimin e personave ose të sendeve;
- v) transferimin e personave në arrest për marrjen në pyetje;
- dh) ekzekutimin e kërkesave për kontroll dhe konfiskim;
- vi) identifikimin, gjurmimin, sekuestrimin, si dhe konfiskimin e të ardhurave dhe sendeve të krimit dhe ndihmë në procedurën/procedimet lidhur me to;
- vii) njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të çështjeve penale;
- viii) çdo veprim tjetër procedural të nevojshëm në një procedim penal, për të cilin është rënë dakord mes palëve.

Neni 2

Autoritetet qendrore dhe gjyqësore

1. Për qëllim të kësaj Marrëveshjeje:

- i) Autoritetet qendrore janë ministritë e drejtësisë të palëve respektive;
- ii) Autoritetet gjyqësore janë:
 - a) për Republikën e Shqipërisë: Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit, gjykatat e shkallës së parë, Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë pranë gjykatave të apelit dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë;
 - b) për Republikën e Kosovës: Gjykatat Themelore, gjykata e apelit, gjykata supreme, prokuroritë themelore, Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 3

Komunikimi dhe përcjellja e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike

1. Kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike përfshin letër-kërkesat sipas legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë dhe lutjet, dhe letërporositë sipas legjislacionit të brendshëm të Republikës së Kosovës brenda fushës së bashkëpunimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kërkesa e autoriteteve gjyqësore të njëres palë u përcillet me shkrim autoriteteve gjyqësore të palës tjetër nëpërmjet autoriteteve qendrore, ndërsa në raste urgjente mund të dërgohet drejtpërdrejt nëpërmjet autoriteteve gjyqësore të palëve, duke njoftuar njëkohësisht autoritetin qendror përkatës.

3. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese përcillen në origjinal apo kopje të njësuara me origjinalin.

4. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese dorëzohen nëpërmjet shërbimit postar, kanaleve diplomatike ose nëpërmjet mjeteve të tjera teknike të përshtatshme, por me kusht që të konfirmohet marrja në dorëzim.

5. Autoritetet gjyqësore të palëve i ekzekutojnë kërkesat pa vonesë.

6. Kërkesa dorëzohet në gjuhën shqipe për Ministrinë e Drejtësisë së Republikë së Shqipërisë dhe në gjuhën shqipe ose serbe për Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës.



Neni 4 **Kërkesa**

1. Kërkesa, për aq sa është e mundur, përmban:
 - i) autoritetin kërkues dhe emrin e autoritetit të kërkuar;
 - ii) përcaktimin e saktë të llojit të kërkesës që krijon marrëdhënien juridiksionale ndërmjet dy palëve, arsyet e dërgimit dhe bazën ligjore;
 - iii) një përshkrim të procedimit penal që është duke u zhvilluar;
 - iv) një përshkrim të faktit penal, duke treguar kohën dhe vendin e tij, emërtimin ligjor të veprës penale, si dhe kopje të tekstit të dispozitave ligjore të brendshme të zbatueshme;
 - v) gjenealogjetet e personit që ka lidhje me objektin e kërkesës, si dhe pozitën e tij në procedimin penal;
 - vi) aktet që i bashkëngjiten kërkesës, nëse ka, të evidentuara edhe në një listë;
 - vii) deklarin nëse çështja është urgjente dhe afatin brenda të cilit nevojitet ekzekutimi, së bashku me arsyet e urgjencës apo afatit;
 - viii) një përshkrim të ndonjë procedure të veçantë për t'u ndjekur gjatë ekzekutimit të kërkesës;
 - ix) kërkesën për ruajtjen e konfidencialitetit mbi kërkesën, nëse është e nevojshme, si dhe arsyen për këtë qëllim;
 - x) çdo informacion tjetër që mund të jetë me rëndësi për procedurën e ekzekutimit të kërkesës.
2. Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese nënshkruhen dhe vulosen nga autoriteti kërkues.
3. Pala e kërkuar mund të kërkojë informacion shtesë nëse e vlerëson të nevojshme për ekzekutimin e kërkesës.

Neni 5 **Refuzimi i ndihmës së ndërsjellë juridike**

1. Ndihma e ndërsjellë juridike mund të refuzohet kur:
 - i) Kërkesa u referohet veprave penale që pala e kërkuar i konsideron vepra penale politike ose që lidhen me vepra penale politike ose vepra penale ushtarake;
 - ii) Pala e kërkuar konsideron se ekzekutimi i kërkesës mund të cenojë sovranitetin, sigurinë, rendin publik dhe interesat e tjerë esencialë të vendit të saj.
2. Në rast të veprave penale kundër njerëzimit apo vlerave të tjera mbrojtura nga e drejta ndërkombëtare, tentativave për t'i kryer ato, si dhe bashkëpunimit në kryerjen e tyre, palët nuk mund të refuzojnë kërkesat, me shkakun se përbëjnë vepra penale politike.
3. Akti i refuzimit të një kërkesë përmban arsyet e refuzimit dhe bazën ligjore.

Neni 6 **Ekzekutimi i kërkesës**

1. Pala e kërkuar ekzekuton, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin e saj të brendshëm, kërkesat sipas kësaj Marrëveshjeje.
2. Pala e kërkuar mund të zbatojë një procedurë të veçantë që kërkohet shprehimisht nga pala kërkuese në ekzekutimin e kërkesës deri në atë masë që një procedurë e tillë nuk është në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të palës së kërkuar.
3. Nëse pala kërkuese e kërkon shprehimisht, pala e kërkuar duhet të njoftojë për datën dhe vendin e ekzekutimit të kërkesës.

4. Autoritetet kompetente të palës së kërkuar, me kërkesë të autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese, mund të lejojnë përfaqësues të autoriteteve gjyqësore të palës kërkuese të marrin pjesë në marrjen e provës dhe t'i drejtojnë pyetje personit që pyetet, sipas legjislacionit të palës së kërkuar.

5. Pala e kërkuar mund të shtyjë ose të kushtëzojë ekzekutimin e kërkesës nëse ekzekutimi i saj ndikon në mbarëvajtjen e procedimeve penale të filluara nga autoritetet gjyqësore të palës së kërkuar. Në këtë rast pala e kërkuar njofton palën kërkuese për arsyet e shtyrjes ose të kushtëzimit të ekzekutimit të kërkesës.

6. Në rastet kur pala e kërkuar konstaton që kërkesa për ndihmë juridike të ndërsjellë nuk mund të përmbushet, atëherë duhet të informojë palën kërkuese menjëherë dhe të specifikojë arsyet e mospërmbushjes. Kërkesa origjinale dhe dokumentet e bashkëngjitura duhet t'i kthehen palës kërkuese pa vonesë.

7. Pas ekzekutimit të kërkesës për ndihmë juridike të ndërsjellë, pala e kërkuar duhet t'i përcjellë kopjet e certifikuara të të dhënave ose të dokumenteve të kërkuara, përveç nëse pala kërkuese shprehimisht kërkon përcjelljen e origjinaleve.

Neni 7

Konfidencialiteti

1. Pala kërkuese mund të kërkojë që pala e kërkuar të ruajë si konfidenciale faktin e dorëzimit të kërkesës, si dhe të përmbajtjes së saj, deri në atë masë sa është e nevojshme për ekzekutim të kërkesës. Nëse pala e kërkuar nuk mund të veprojë në përputhje me kërkesën e konfidencialitetit, atëherë duhet të informojë palën kërkuese për këtë brenda një afati të arsyeshëm.

2. Kushdo që ka akses në të dhënat personale të mbledhura, të ruajtura dhe të përpunuara nga institucionet kompetente për zbatimin e marrëveshjes, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre edhe pas përfundimit të funksioneve, i nënshtrohet detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit dhe mospërhapjes së asnjë informacioni, përveç kur parashikohet ndryshe me ligjin e brendshëm të secilës palë.

3. Palët në këtë marrëveshje, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje. Të dhënat nuk duhet të përhapen, përveç rasteve të parashikuara në legjislacionet respektive.

Neni 8

Mbrojtja e të dhënave personale

1. Pala, së cilës i janë përcjellë të dhënat personale nga pala tjetër si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje, mund t'i shfrytëzojë ato vetëm për:

- i) qëllime të procedurave penale, për të cilat vlen kjo Marrëveshje;
- ii) procedura të tjera gjyqësore ose administrative të lidhura drejtpërsëdrejti me procedurën penale të parashikuar në nënparagrafin "i" të këtij paragrafi;
- iii) parandalimin e kërcënimit të menjëhershëm dhe serioz për sigurinë publike.

2. Të dhënat personale mund të shfrytëzohen për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëse pala që i ka dorëzuar ato ose subjekti i të dhënave jep paraprakisht pëlqimin me shkrim.

3. Secila palë mund të refuzojë transferimin e të dhënave personale të fituara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje nëse:

- i) cenohen interesat e sigurisë kombëtare, politika e jashtme, interesat ekonomikë dhe financiarë të shtetit, liria e shprehjes dhe e informimit apo liria e shtypit ose për parandalimin dhe ndjekjen e veprave penale; dhe



ii) pala së cilës duhet t'i transferohen të dhënat nuk siguron një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me legjislacionin e brendshëm për mbrojtjen e të dhënave personale dhe standardet e parashikuara në aktet ndërkombëtare përkatëse, përveç nëse pala e fundit merr përsipër të bëjë mbrojtjen e të dhënave personale siç kërkohet nga pala tjetër.

4. Pala e cila ka transferuar të dhënat personale të fituara si rezultat i ekzekutimit të kërkesës së dorëzuar në përputhje me këtë Marrëveshje, kërkon nga pala tjetër të japë informacion rreth përdorimit të tyre, përfshirë këtu edhe afatin e mbajtjes së të dhënave deri në shkatërrimin e tyre.

5. Institucionet e secilës palë në këtë Marrëveshje që zbatojnë dispozitat e saj, marrin të gjitha masat e duhura organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale nga shkatërrimi i jashtëligjshëm ose aksidental, humbja aksidentale, aksesit ose përhapja të persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave kryhet në rrjet, si dhe çdo formë tjetër përpunimi të jashtëligjshëm.

KAPITULLI II EKZEKUTIM I KËRKESAVE SIPAS LLOJEVE

Neni 9

Shërbimi i thirrjeve dhe i dokumenteve gjyqësore

1. Pala kërkuuese mund të kërkojë nga pala e kërkuar:

i) njoftimin e aktit të thirrjes ndaj palëve në procedimin penal, dëshmitarit apo ekspertit;
ii) njoftimin e urdhrave, vendimet e autoriteteve gjyqësore dhe të dokumenteve të tjera të nevojshme që lidhen me procedimin penal në palën kërkuuese.

2. Kërkesa për dorëzim të letërthirrjes për të pandehurin duhet t'i përcillet autoritetit qendror të palës së kërkuar jo më vonë se 45 ditë para datës së caktuar për paraqitje të të pandehurit në territorin e palës kërkuuese, me përjashtim të rasteve urgjente të cilat afati mund të shkurtohet.

3. Dorëzimi dokumentohet sipas legjislacionit të brendshëm të secilës palë.

4. Secila palë ka të drejtën që nëpërmjet përfaqësuesve të saj diplomatikë dhe konsullorë, të vendosë në dispozicion dokumente ose të dhëna zyrtare, të kërkuara nga shtetasit e saj, të cilët ndodhen në territorin e palës së cilës i drejtohet kërkesa, në përputhje me legjislacionin e brendshëm që rregullon çështjen e informimit të publikut me dokumentet zyrtare dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 10

Paprekshmëria e personit të thirrur

1. Një dëshmitar ose ekspert dëshmitar, pavarësisht nga shtetësia e tij, i cili paraqitet pas ftesës nga pala kërkuuese, nuk duhet të ndiqet penalisht, të ndalohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale të tij në territorin e saj në lidhje me veprat e kryera ose dënimet e dhëna para nisjes së tij nga territori i palës së kërkuar.

2. Një person, pavarësisht nga shtetësia e tij, i thirrur para autoriteteve gjyqësore të palës kërkuuese si i pandehur për t'u përgjigjur për aktet për të cilat ai akuzohet, nuk duhet të ndiqet, të ndalohet ose t'i nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë personale në territorin e saj në lidhje me veprat e kryera ose dënimet e dhëna para nisjes së tij nga territori i palës së kërkuar dhe të cilat nuk janë të specifikuar në kërkesa.

3. Vlefshmëria e garancive të parapara me këtë nen duhet të pushojë nëse:

4. Dëshmitari, eksperti dëshmitar ose i pandehuri mbetet në territorin e palës së kërkuar më shumë se 15 ditë prej kur prania e tij nuk është e nevojshme nga autoritetet gjyqësore edhe pse ai/ajo ka pasur mundësinë të largohet nga territori. Ky afat nuk përfshin periudhën gjatë së cilës personi i thirrur nuk mund të largohet nga territori për shkaqe të ligjshme të dokumentuara.

5. Dëshmitari, dëshmitari ekspert ose i pandehuri, pas lëshimit të palës kërkuese, kthehet në territorin e saj në mënyrë vullnetare.

Neni 11

Seancat dëgjimore nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit

1. Në rastet kur personi që gjendet në territorin e cilësdo palë duhet të dëgjohet si dëshmitar ose ekspert nga organet gjyqësore të palës tjetër, kjo e fundit, nëse nuk është e dëshirueshme ose e mundshme që personi të paraqitet në territorin e saj personalisht, mund të kërkojë dëgjimin përmes mjeteve të telekomunikimit.

2. Përveç të dhënave të përcaktuara në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, kërkesa për dëgjim përmban:

i) arsyen pse nuk është e dëshirueshme ose e mundshme që dëshmitari ose eksperti të paraqitet personalisht;

ii) emrin e autoritet gjyqësor dhe emrin e personave që do të drejtojnë seancën dëgjimore.

3. Seanca dëgjimore zhvillohet sipas rregullave të mëposhtme:

i) Organi gjyqësor i palës së kërkuar duhet të jetë i pranishëm gjatë dëgjimit dhe është përgjegjës për të siguruar identifikimin e personit që duhet dëgjuar dhe respektimin e parimeve themelore të ligjeve të palës së kërkuar. Nëse organi gjyqësor i palës së kërkuar vlerëson se gjatë dëgjimit parimet themelore të ligjit të palës së kërkuar janë duke u shkelur, atëherë ai menjëherë merr masat e domosdoshme për të siguruar që dëgjimi të vazhdojë në përputhje me parimet e lartpërmendura.

ii) Masat për mbrojtjen e personit që duhet dëgjuar, duhet të miratohen, nëse është e nevojshme ndërmjet autoriteteve gjyqësore të të dyja palëve;

iii) Me kërkesë të palës kërkuese ose të personit që duhet dëgjuar, pala e kërkuar duhet të sigurojë që personi që duhet dëgjuar të ndihmohet nga përkthyesi nëse është e nevojshme;

iv) Personi që duhet dëgjuar mund të shfrytëzojë të drejtën për të mos dëshmuar në përputhje me ligjin e secilës palë.

4. Pa cenuar masat e miratuara për mbrojtjen e personave, organi gjyqësor i palës së kërkuar harton procesverbalin e dëgjimit, që përfshin:

i) datën dhe vendin e dëgjimit;

ii) identitetin e personit të dëgjuar;

iii) identitetet dhe funksionet e personave të tjerë në palën e kërkuar që marrin pjesë në dëgjim;

iv) betimet e dhëna;

v) kushtet teknike nën të cilat është realizuar dëgjimi; dhe

vi) zbatimin e masave të mbrojtjes.

5. Palët marrin masat e nevojshme për zbatimin e legjislacionit të brendshëm kur dëshmitari ose eksperti që dëgjohet, refuzon për të dëshmuar apo jep dëshmi të rreme.

Neni 12

Transferimi i përkohshëm i personave të ndaluar

1. Nëse pala kërkuese kërkon paraqitjen e një personi të ndaluar në paraburgim ose burgim në territorin e palës tjetër për të dëshmuar, ai/ajo mund të transferohet përkohësisht në shtetin e palës kërkuese, me kusht që të ritransferohet brenda periudhës së përcaktuar nga ana e palës së kërkuar.

2. Transferimi i përkohshëm i personit vendoset nga autoriteti qendror nëse pala kërkuese jep garanci për mbrojtjen dhe kthimin e personit brenda periudhës së përcaktuar.



3. Transferimi mund të refuzohet nëse:
 - i) personi i ndaluar nuk jep pëlqimin e tij për një gjë të tillë;
 - ii) prania e tij është e nevojshme në një procedim penal që po zhvillohet në territorin e palës së cilës i drejtohet kërkesa;
 - iii) transferimi i tij do të zgjasë më tej gjendjen e tij të ndalimit; ose
 - iv) ka arsye të tjera thelbësore për të mos e transferuar atë.
4. Dorëzimi i të pandehurit mund të shtyhet nëse prania e tij është e domosdoshme në procedurën penale që zhvillohet në territorin e palës së kërkuar.
5. Në rast të dorëzimit të përkohshëm të të pandehurit nga një shtet i tretë te njëra nga palët, përmes territorit të palës tjetër, kjo e fundit, në përputhje me këtë Marrëveshje, duhet të lejojë transitin e tij përmes territorit të vet, me kusht që i pandehuri të mos jetë shtetas i saj.
6. Personi i dorëzuar duhet të mbahet në paraburgim në territorin e palës kërkuese dhe në rastet kur aplikohet, edhe në territorin e palës përmes territorit të të cilit lejohet transiti, përveç nëse pala nga e cila kërkohet dorëzimi kërkon lirimin e tij. Koha e ndalimit në palën kërkuese llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit përfundimtar.
7. Në rastet kur qëllimi i specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni plotësohet, pala kërkuese duhet të kthejë menjëherë personin e dorëzuar te pala e kërkuar, përveç nëse kjo e fundit kërkon lirimin e tij. Personi i dorëzuar ka të drejtat e specifikuara në nenin 10 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Konfiskimi dhe dorëzimi i sendeve

1. Kërkesa për konfiskim dhe dorëzim të sendeve pranohet kur fakti për të cilin procedon pala kërkuese parashikohet si vepër penale në legjislacionin e secilës palë.
2. Kërkesa për konfiskim dhe dorëzim të sendeve duhet të shoqërohet nga vendimi i organit kompetent gjyqësor të palës kërkuese që urdhëron konfiskimin e atij sendi.
3. Pala e kërkuar mund të shtyjë dorëzimin e sendit, të dhënave ose dokumenteve të kërkuara nëse sendi, të dhënat ose dokumentet në fjalë kërkohen për qëllime të procedurave penale të veta të papërfunduara.
4. Sendet, të dhënat origjinale ose dokumentet e dorëzuara tek pala kërkuese gjatë ekzekutimit të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike, duhet t'i kthehen palës së kërkuar sa më shpejt që është e mundur, përveç nëse kjo e fundit heq dorë nga kthimi.
5. Paragrafët 1 - 3 të këtij neni nuk duhet të cenojnë interesat legjitimë të personave të interesuar, duke përfshirë palët e treta në mirëbesim, në lidhje me sendet e konfiskuar dhe të dorëzuara.

Neni 14

Transferimi i procedurës penale

1. Palët mund t'i kërkojnë njëra - tjetrës transferimin e procedurës penale me kusht që pala e kërkuar të ketë kompetencë për të ushtruar ndjekjen penale.
2. Transferimi i procedurës penale mund të lejohet nëse shtetasi i njëres palë ose personi që jeton në territorin e saj kryen në territorin e palës tjetër një vepër të dënueshme të parashikuar nga ligjet e të dyja palëve.
3. Transferimi i procedurës penale lejohet pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me ligjin e palës së kërkuar.
4. Organi kompetent gjyqësor i palës së kërkuar duhet të kryejë procedurat penale në përputhje me ligjin e vet.
5. Kërkesa për transferim, krahas të dhënave të përcaktuara në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, duhet të shoqërohet edhe nga dosja origjinale ose nga kopja e njëzuar e saj.

6. Kur pala kërkuese ka kërkuar transferimin e procedurës/procedimit, ajo nuk mund të vazhdojë më ndjekjen penale të personit për veprën penale për të cilën është kërkuar transferimi apo të ekzekutojë një vendim i cili është shpallur në shtetin e asaj pale kundër personit për të njëjtën veprë penale. Megjithatë, pala kërkuese ka të drejtë të ndërmarrë të gjitha hapat për ndjekjen penale ose për dërgimin e çështjes në gjyq deri në momentin kur ajo merr vendimin e palës së kërkuar mbi pranimin e transferimit.

7. E drejta e ndjekjes penale dhe ekzekutimit të vendimit i kthehet palës kërkuese nëse pala e kërkuar njofton për vendimin e saj për të refuzuar transferimin e procedurës për shkak se nuk përmbushen kushtet e parashikuara në legjislacionin e saj të brendshëm apo vendimin e saj për tërheqjen e pranimin të kërkesës së transferimit për shkak se pas pranimin ka lindur një arsye për të mos vijuar më ndjekjen penale të procedimit.

8. Pala e kërkuar informon palën kërkuese rreth rezultatit të ecursë së procedurës penale dhe dorëzon vendimin përfundimtar ose kopjen e njësuar të tij.

Neni 15

Shpenzimet e shërbimeve gjyqësore

1. Palët heqin dorë nga rimbursimi i shpenzimeve të ekzekutimit të kërkesave, me përjashtim të rasteve:

i) të shpenzimeve të një dëshmitari ose eksperti që paraqitet për ekzekutimin e një kërkesë tek autoritetet gjyqësore të palës së kërkuar. Në këtë rast eksperti ose dëshmitari kompensohet sipas legjislacionit të palës kërkuese. Kërkesa përmban shumën e përafërt të shpenzimeve që do të kompensohen.

ii) të shpenzimeve për transferimin e përkohshëm të personave të ndaluar, të parashikuar në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.

iii) të shpenzimeve për kryerjen e veprimeve procedurale që kanë shpenzime të larta apo të jashtëzakonshme.

2. Autoritetet qendrore të palëve konsultohen paraprakisht me njëra-tjetrën me qëllim arritjen e një marrëveshjeje për kushtet në të cilat do të ekzekutohet letërporosia si mënyrën e kryerjes së pagesës së shpenzimeve të parashikuara në nënparagrafin “iii” të paragrafit “1” të këtij neni.

Neni 16

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore penale

Të dyja palët njohin dhe ekzekutojnë vendimet gjyqësore penale të dhëna nga gjykatat kompetente të tyre në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm.

KAPITULLI III

TRANSFERIMI I TË DHËNAVE

Neni 17

Të dhëna mbi legjislacionin

Autoritetet qendrore i ofrojnë njëra-tjetrës sipas kërkesës tekstin e dispozitave ligjore në fuqi ose që kanë qenë në fuqi në territorin e palëve, si dhe informatat rreth çështjeve të caktuara ligjore.



Neni 18

Zyra e gjendjes gjyqësore

Pala e kërkuar do të transferojë të dhëna personale që disponon zyra e gjendjes gjyqësor në masën që kërkojnë autoritetet e tyre gjyqësore, nëse një gjë e tillë kërkohet nga autoritetet kompetente të palës kërkuese dhe janë të nevojshme për procesin penal.

Neni 19

Shkëmbimi i informacioneve

1. Secila palë informon palën tjetër për vendimet penale dhe dënimet përkatëse të dhëna nga autoritetet e tyre gjyqësore që i përkasin shtetasve të palës tjetër dhe që kanë qenë objekt i regjistrimit në kartotekën gjyqësore (zyrën e gjendjes gjyqësore).

2. Autoritetet qendrore komunikojnë të dhënat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, në një kohë sa më të shpejtë.

KAPITULLI IV

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 20

Zbatimi dhe interpretimi i Marrëveshjes

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje zbatohen për kërkesat për ndihmë të ndërsjellë juridike që lidhen me veprat penale që janë kryer para dhe pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve lidhur me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet rrugëve diplomatike, ose nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve qendrore të palëve, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të tyre.

Neni 21

Autoritetet gjyqësore të Republikës së Kosovës

Deri më 1 janar 2013, në Republikën e Kosovës, autoritetet gjyqësore janë: Gjykata Supreme, Gjykatat e Qarkut, gjykata Ekonomike, gjykatat komunale, Zyra e Prokurorit të Shtetit e Republikës së Kosovës, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, zyrat publike të qarkut të Prokurorisë dhe zyrat komunale të Prokurorit Publik.

Neni 22

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit në përputhje me procedurat ligjore të palëve dhe do të hyjë në fuqi 30 ditë pas njoftimit të fundit, përmes kanaleve diplomatike të palëve se procedurat e brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje janë përfunduar.

2. Marrëveshja lidhet për një afat kohor të pacaktuar dhe përfundon 6 muaj pasi njëra nga palët njofton palën tjetër për përfundimin e saj.

3. Secila prej palëve mund të kërkojë denoncimin e Marrëveshjes, në çdo kohë duke i dërguar njoftim me shkrim palës tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Denoncimi i kësaj Marrëveshjeje hyn në fuqi 6 muaj pas marrjes së këtij njoftimi.

4. Institucionet e Republikës së Kosovës të përmendur në paragrafin 12 të nenit 2 të kësaj marrëveshjeje, do të kenë këtë strukturë organizative nga data 11 janar 2013 siç parashikohet me ligjin e aplikueshëm.

Në dëshmi të kësaj të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 6.11.2012, në gjuhët, shqipe dhe serbe, të gjitha tekstet njësoj autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, teksti në gjuhën shqipe do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
ZËVENDËSKRYEMINISTRI DHE
MINISTRI I DREJTËSISË
Hajredin Kuçi

LIGJ
Nr. 4/2013

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E
EKONOMIVE PYJORE, QË PRITET TË PËRMBYTEN NGA LIQENI I HEC-EVE TË
BANJËS, KOKLIT DHE MOGLICËS, TË CILËT DO TË NDËRTOHEN NË KASKADËN E
LUMIT DEVOLL**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Sipërfaqja e fondit pyjor dhe kullosor, që pritët të përmbytet nga liqeni, që do të krijohet si rezultat i ndërtimit nga shoqëria “Devoll Hydropower”, sh.a., të hidrocentraleve të Banjës, Koklit dhe Moglicës, në kaskadën e lumit Devoll, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 1421,39 (një mijë e katërqind e njëzet e një presje tridhjetë e nëntë) ha, që ndodhet në ekonomitë pyjore/kullosore Gostimë - Koprrik, Mollas, Galigat - Storrë, Gramsh - Vinë, Vidhan - Skënderbegas, Darëzezë - Sult dhe Dushku i Bulçarit të qarkut të Elbasanit, si dhe Lavdar - Opar, Voskopoje, Lozhan dhe Moglicë të qarkut të Korçës, të hiqen nga Fondi Pyjor dhe Kullosor Kombëtar dhe të çregjistrohen nga kadastra kombëtare e pyjeve, sipas tabelës 1 dhe hartave, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 2

Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore në terren dhe në hartë, kufijtë e rinj të Fondit Pyjor dhe Kullosor Kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas nenit 1 të këtij ligji, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, kullotë” dhe “Tokë e zënë, pyll” dhe e regjistron në sipërfaqe ujore (liqen) dhe truall për ndërtimin e HEC-eve, në pronësi publike.



Neni 3

Për sipërfaqen e hequr nga fondi pyjor e kullosor dhe për lëndën drusore që do të pritët, shoqëria “Devoll Hydropower”, sh.a. duhet të përfundojë procedurat e pagesës, në bazë të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

Neni 4

Shoqëria “Devoll Hydropower”, sh.a., brenda 3 viteve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 1347,8 (një mijë e treqind e dyzet e shtatë presje tetë) ha me pyje dhe të përmirësojë një sipërfaqe prej 73,6 (shtatëdhjetë e tre presje gjashtë) ha kullotë, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore.

Lloji i drurëve, që do të mbillen, e grafiku i mbjelljeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore, e cila ndjek mbjelljet deri në marrjen në dorëzim, me procesverbal, të sipërfaqes së pyllëzuar dhe kullotës së përmirësuar, sipas marrëveshjes që do të lidhet ndërmjet tyre.

Neni 5

Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, njësitë e qeverisjeve vendore Tregan, Pishaj, Kodovjat, Skënderbegas, Sult të qarkut të Elbasanit dhe komuna Moglicë e qarkut të Korçës për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 31.1.2013

**Shpallur me dekretin nr. 7946, datë 13.2.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Qarku	Emërtimi i ekonomisë	Ngastra	N ngastra	Sip. ha	Përdorimi i territorit	Forma e qeverisjes	Funksioni kryesor	Pronësia	HEC -i
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	001	a	1.36	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	001	c	2.60	pyll	Trungishte	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	015	a	0.32	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	016	a	3.84	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	016	c	32.90	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	030	a	0.45	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	032	b	3.91	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	034	a	0.91	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	038	a	14.43	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	045	a	1.60	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	046	a	1.61	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	046	b	30.54	pyll	Trungishte	Prodhues	Shtet, DSHP Gramsh	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	047	a	2.28	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	047	b	7.11	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	052	a	6.02	Pyll	Cungishte	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	053	b	0.60	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	053	d	8.69	pyll	Trungishte	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	054	a	4.01	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	055	a	1.20	Pyll	Cungishte	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	056	b	0.01	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	091	a	2.17	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	092	a	0.20	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	092	c	1.38	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	093	a	3.92	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	097	b	0.67	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	098	a	10.75	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	100	a	0.07	Pyll	Cungishte	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	100	b	5.96	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	101	a	3.65	Pyll	Cungishte	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	101	b	2.42	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	102	a	3.47	Pyll	Cungishte	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	102	b	13.51	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	103		6.12	Pyll	Cungishte	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	103	b	3.04	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	104	a	13.34	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	104	d	0.99	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	094	b	0.05	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	095	a	5.83	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	095	b	1.35	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	095	d	3.52	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	096	a	4.87	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	096	b	0.09	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	097	b	6.10	pyll	Trungishte	Prodhues	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Galigat - Stror	001	c	13.70	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Stror	002	a	2.20	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja




Elbasan	EP Galigat - Storr	002	c	4.41	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	003	a	7.98	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	003	c	0.39	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	004	c	19.13	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Kodovjat	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	023	d	0.35	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	024	a	0.00	Pyll	Trungishte	Mbrojtës	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	024	c	21.86	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	032	a	0.82	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	052	c	0.09	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	053	a	3.76	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	054	a	6.20	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	055	a	4.15	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	023	a	2.30	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	025	a	6.41	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	026	a	1.01	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	027	a	0.59	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	028	a	5.97	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	029	a	14.02	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	030	a	1.29	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	034	a	0.01	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	037	a	8.52	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	098	a	2.96	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	099	a	8.04	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	001	b	10.59	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	006	a	0.16	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	007	a	0.09	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	008	a	0.25	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	009	a	0.20	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	024	b	0.10	pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Mollas	013	a	1.76	Pyll	Trungishte	Prodhues	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Mollas	014	a	7.39	Pyll	Trungishte	Prodhues	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Mollas	015	a	0.56	Pyll	Trungishte	Prodhues	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	004	b	0.48	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Gramsh	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	006	b	0.64	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Gramsh	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	063	a	4.38	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	063	b	2.77	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	065	a	1.34	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	066	c	2.24	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	066	d	6.74	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	068	a	1.69	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	068	b	5.58	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Korçë	EP Lavdar - Opar	031	a	1.05	Pyll	Shkurre	Prodhues	Pronë private	Moglicë
Korçë	EP Lavdar - Opar	032	a	3.51	Pyll	Shkurre	Prodhues	Pronë private	Moglicë
Korçë	EP Lavdar - Opar	033	a	4.23	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lavdar - Opar	036	a	5.75	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	150	a	1.96	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë


Korçë	EP Lozhan	152	a	1.24	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	153	a	13.74	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	154	a	7.09	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	155	a	6.75	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	156	a	10.19	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	157	a	11.68	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	159		4.84	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	160		10.81	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	161	a	10.51	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	162		3.89	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	163		0.11	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	165	a	6.90	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	166		6.32	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	169		4.55	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	175		1.92	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	176		2.65	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	181		0.02	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	187	a	0.07	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	019	a	2.74	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	020	a	2.18	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	021	a	0.77	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	022	a	32.67	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	024	a	17.97	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	028	a	7.05	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	029	a	7.39	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	032	a	2.98	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	032	b	0.21	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	033	a	2.54	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	035	a	26.83	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	036	a	8.70	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	037	a	44.81	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	038	a	4.75	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	040	a	3.72	Pyll	Shkurre	Prodhues	Pronë private	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	044	a	6.07	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	045	a	14.30	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Voskopojë 2	090	a	1.14	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Voskopojë 2	091	a	1.77	pyll	Cungishte	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Voskopojë 2	092	a	1.57	Pyll	Shkurre	Prodhues	Pronë private	Moglicë
Korçë	EP Voskopojë 2	094	a	0.57	Pyll	Shkurre	Prodhues	Pronë private	Moglicë
Korçë	EP Voskopojë 2	095	a	3.06	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	017	a	7.14	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	029	a	4.07	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	091	a	1.25	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	002	c	4.00	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	036	c	2.26	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzezë - Sult	039	c	1.00	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja





Elbasan	EP Darëzeze - Sult	051	c	0.50	djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	054	c	7.91	djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	097	c	1.73	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	098	c	1.67	djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	099	d	1.48	djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	100	c	2.12	djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	104	c	8.38	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	004	a	17.09	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	024	b	43.00	Pyll	Shkurre	Prodhuës	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	100	a	0.82	Tokë me b.pyjore	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Korçë	EP Voskopojë 2	094	b	28.25	djerr	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	000		203.95	Shtrat lumi, djerr	Nuk ka	Nuk ka	Shtet	Banja
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	094	c	4.68	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	096	d	8.33	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	097	a	12.46	Pyll	Shkurre	Prodhuës	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	028	c	2.87	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	003	a	0.82	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Gramsh	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	005	a	0.22	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Gramsh	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	007	b	1.79	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Gramsh	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	064	c	3.65	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	065	c	2.46	Pyll	Shkurre	Prodhuës	K. Skënderbegas	Kokel
Korçë	EP Lavdar - Opar	000		12.98	Shtrat lumi, djerr	Nuk ka	Nuk ka	Shtet	Moglicë
Korçë	EP Lavdar - Opar	032	b	5.14	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Pronë private	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	154	c	11.34	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	155	c	10.00	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Lozhan	156	c	45.00	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	000		29.48	Shtrat lumi, djerr	Nuk ka	Nuk ka	Shtet	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	020	b	0.98	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	036	b	6.27	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	016	e	6.68	Pyll	Shkurre	Prodhuës	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	051	b	1.05	Pyll	Shkurre	Prodhuës	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Darëzeze - Sult	056	c	1.79	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Sult	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	003	d	9.90	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	004	d	25.04	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	005	a	4.34	Pyll	Shkurre	Prodhuës	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Galigat - Storr	019	c	0.17	Djerr	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	024		23.29	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	038		9.05	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Elbasan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	095	a	19.25	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	096	a	0.47	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	097	a	7.68	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gostimë - Koprik	101		4.46	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	K. Tregan	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	005	b	0.06	Kullotë	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	008	c	0.20	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Mollas	012	a	0.85	Pyll	Trungishte	Prodhuës	Pronë private	Banja
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	064	e	0.99	Pyll	Shkurre	Prodhuës	K. Skënderbegas	Kokel


Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	066	a	3.16	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Korçë	EP Lozhan	151	a	2.66	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	019	b	2.46	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	027		5.79	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	043	a	16.23	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	043	b	2.70	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Voskopojë 2	088	a	1.04	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Voskopojë 2	093	a	0.95	Pyll	Shkurre	Prodhues	Pronë private	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	031	a	1.13	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Moglicë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	034	a	0.36	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	034	d	3.87	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	096	a	8.57	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	097		8.36	Pyll	Shkurre	Prodhues	Shtet, DSHP Korçë	Moglicë
Korçë	EP Moglicë	038	a	24.04	Pyll	Shkurre	Prodhues	Pronë private	Moglicë
Elbasan	EP Galigat - Stror	032	c	1.20	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Gramsh - Vinë	008	d	0.20	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Pishaj	Banja
Elbasan	EP Mollas	013	a	1.00	Pyll	Trungishte	Prodhues	Pronë private	Banja
Elbasan	EP Dushku i Bulçarit	097	d	5.30	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Kodovjat	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	064	a	3.15	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	066	b	2.15	Pyll	Shkurre	Prodhues	K. Skënderbegas	Kokel
Elbasan	EP Vidhan - Skënderbegas	066	h	2.15	Inproduktive	Nuk ka	Nuk ka	K. Skënderbegas	Kokel
TOTALI				1421.40					




















Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 15.2.2013
Doli nga shtypi më 18.2.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 46 lekë